26453

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT TIRANE**
**Nr.26453...i Vendimit**

# V E N D I M
## (PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK)

Ne Tirane , sot me daten 28.09.2001, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane Z. Sollaku, mbasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi **z.Luan ALLIU** , per rregjistrimin si " **Person Juridik**" te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar,**ortak i vetem ,"MEGI 2001 " SH.P.K. Hotelisht Librazhd**

### K O N S T A T O V A:

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi z.Luan ALLIU per rregjistrimin si " **Person Juridik**", te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar , **"MEGI 2001 " Ortak i Vetem, SH.P.K. Hotelisht Librazhd** , me administrator.Luan ALLIU ,me kapital themelor 100.000 ( njeqindmije) leke te reja, me kohe zgjatje mbi 10 vjet , me seli ne katundin Hotelisht Librazhd , **me objekt veprimtarie:"Ndertimi i objekteve te ndryshme civile e industriale , private e shteterore per persona fizik dhe juridik . Importimi dhe ekspotimi te materjaleve te ndertimit e te atyre inerte , te artikujve industriale dhe ushqimore . Si dhe transportim udhetaresh"**. Eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

### PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit nr. 7638 , date 19.11.1992 , dhe ligjit nr.7667, date 28.01.1993 .

### V E N D O S A:

Rregjistrimin si " **Person Juridik** " te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar , **Ortak i Vetem, "MEGI 2001 " , SH.P.K.**,me administrator z. Luan ALLIU , me kapital themelor 100.000 (njeqindmije) leke te reja , me seli ne fshatin Hotelisht te Rrethit Librazhdit , me kohe zgjatje mbi 10 vjet, me objekt veprimtarie :" **Ndertimi i objekteve te ndryshme civile e industriale , private e shteterore per persona fizike e juridike . Importimi dhe ekspotimi i materjaleve te ndertimit si dhe te atyre inerte , te artikujve ushqimore e veshmbathje .Transportimi i udhetareve** ".Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane .

**GJYQTARE :**
( Zegjine Sollaku )

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr.26453/1 i Vendimit.

VENDIM nr.1
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me daten 16.11.2001, une gjyqtare e vetme e Gjykates se Rrethit Tirane ______ mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga ortaku i vetem z.Luan ALLIU, i cili eshte administrator i shoqerise "MEGI 2001" SH.P.K., si dhe vendimin e ortakut te vetem, per depozitimin e ketij vendimi ne rregjistrin tregtar dhe :

KONSTATOVA

Se me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr. 26453, date 28.09.2001 eshte rregjistruar si person juridik ne rregjitrin tregtar SHOQERIA " MEGI 2001", SH.P.K., me ortak te vetem dhe administrator te saj z. Luan ALLIU.

Me vendimin e tij te dates 15.10. 2001, ortaku i vetem ka vendosur shtimin e objektit te veprimtarise te kesaj SHOQERIE e konkretisht te nenit 5 te aktit te themelimit si dhe nenit 4 te statutit dhe konkretisht : Krijimi i nje Agjensije Transporti Udhetaresh dhe mallrash ne qytetin e Librazhdit.

Kerkesa eshte e drejte dhe ne baze te ligjit duhet pranuar

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit nr.7667, date 28.01.1993 : " Per Rregjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe duhen Respektuar nga Shoqerite Tregtare.

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne zyren e rregjistrit tregtar Tirane, te vendimit date 15.10.2001 te ortakut te vetem z. Luan ALLIU te SHOQERISE "MEGI 2001", ku eshte vendosur shtimi i objektit ne nenet 5 te Aktit te Themelimit e 4 te Statutit, duke shtuar : " Krijimi i nje Agjensie Transporti udhetaresh e mallrash ne qytetin e Librazhdit.

Ky ndryshim te pasqyrohet edhe ne rregjistrin tregtar prane kesaj Gjykate.

GJYQTARJA :
( ______ )

URDHËR REGJISTRIMI
GJYKATA E RRETHIT TIRANË
REGJISTRI I SHOQËRIVE TREGTARE

# URDHËR REGJISTRIMI

| | |
|---|---|
| Kolona I | Numri i Regjistrit Tregtar: 26453 |
| Kolona II | A. Emri i Shoqërisë: "MEGI 2001" SH.P.K<br>B. Selia: Hotelisht, Librazhd<br>C. Objekti: ne fushen e ndertimit te objekteve te ndryshme civile e industriale, private e shteterore etj.<br>D. Kapitali: 100.000 |
| Kolona III | A. Ortakët Luan Alliu<br>B. Administratorët: Luan Alliu, i biri i Eminit, dtl.1967 lindur dhe banues ne Hotelisht Librazhd |
| Kolona IV | Kohëzgjatja: mbi 10 vjet |
| Kolona V | Shënime mbi aktet e shoqërisë:<br>A. Data e Nënshkrimit: 28.09.2001<br>B. Data e regjistrimit: 15.10.2001<br>C. Statuti fletë: 4 flete<br>D. Akti i Themelimit fletë 1 flete |

*Shënime:* 100.000 leke të derdhur para noterit Vangjel Daka Tirane, date 28.09.2001

GJYQTARE
ZEGJINE SOLLAKU

## AKTI I THEMELIMIT
**( Te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " MEGI 2001 " SH.P.K.)**

**NENI 1**

Themeluesi i kesaj shoqerije eshte z. Luan ALLIU , i biri i Eminit , i datelindjes 10.07.2001 lindur dhe banues ne katundin Hotelisht te Rrethit Librazhdit .

**NENI 2**

Themeluesi i siperm ka vendosur te krijoje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar , te cilen do ta quaje " MEGI 2001 "

**NENI 3**

Selia e kesaj Shoqerie do te jete ne katundin Hotelisht te Rrethit Librazhdit .Me vendim te ortakut te vetem , shoqerija mund te hape filjale edhe ne rrethe te tjera te vendit .

**NENI 4**

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete mbi 10 vjete , me perjashtim te rasteve te parashikuara ne statut

**NENI 5**

Shoqeria ka si objekt veprimtarije :"Ndertimi i objekteve te ndryshme civile e industriale , private ose shteterore , per persona fizike dhe juridike . Importim dhe eksportimi i materjaleve te ndertimit dhe te inerteve , i artikujve industriale dhe ushqimore . Transportim udhetaresh .

**NENI 6**

Kapitali themelor i shoqerise do te jete 100.000 leke te reja .

**NENI 7**

Adminitrator i shoqerise do te jete vete ortaku i vetem z. Luan ALLIU .

**NENI 8**

Shoqeria do te rregullohet pervec ketij akti themelor edhe me normat e percaktuara ne statutin e saj , i cili do te neneshkruhet nga ortaku i vetem dhe do te miratohet nga Gjykata e Rrethit Tirane , ne diten kur do te legalizohet si person juridik .

**THEMELUESI I SHOQERISE**
**LUAN ALLIU**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE** — **Nr.3246 Rep.**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE** — **Nr..203..Kol**

## V E R T E T I M

Sot me daten 28.09.2001 , para meje noterit Vangjel DAKA u paraqit personalisht z.Luan ALLIU , i biri i Eminit , i datelindjes 10.07.1967 , lindur dhe banues ne katundin Hotelisht te Rrethit Librazhdit , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar , i paisur me pasaporten me nr.495728 i cili deklaroje se sa me siper eshte shkruar sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote , e neneshkroi ate regullisht perpara meje noterit kurse une e vertetoj sipas ligjes .



**NOTERI**
**VANGJEL DAKA**

# S T A T U T I

## ( I Shoqerise Tregetare"MEGI 2001" SH P K. )

## FORMIMI :

NENI 1

Ne baze te ligjit nr. 7638 date 19.11. 1992, dhe ligjit nr.7667 date 28.01 1993 Formohet Shoqeria Tregtare me emertimin " **MEGI 2001" SH.P.K** si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar , themeluesi i te cilit eshte z. Luan ALLIU , i biri i Eminit e Ballkizes , i datelindjes 10.07.1967., lindur dhe banues ne katundin Hotelisht te Rrethit Librazhdit .

Kjo shoqeri fiton personalitetin e saj juridik qe nga dita e rregjistrimit ne zyren e rregjistrit tregtare te Gjykates se Rrethit Tirane .

## SELIA:

NENI 2

Selia e Shoqerise Tregtare" **MEGI 2001 " SH.P.K**. eshte ne fshatin Hotelisht te Rrethit Librazhdit. Me vone ajo mund te hape edhe vend qendrime te tjera te dyta , operative ,filiale , perfaqesi e agjensi ne te gjithe territorin e Shqiperise , me miratimin e Organeve drejtuese perkatese dhe sipas ligjilacionit ne fuqi .Administratori i saj do te jete , ortaku i vetem z.Luan ALLIU .

## KOHE ZGJATJA :

NENI 3

Jete gjatesia e SHOQERISE eshte mbi 10 vjete , me perjashtim te rasteve kur vendoset shperdarja e saj nga organi koopetent ,si dhe rastet kur krijohen rrethana te tilla ,kur shperndarja e saj parashikohet ne ligj .

## OBJEKTI i VEPRIMTARISE

NENI 4

**Objekti i veprimtarise te Shoqerise Tregetare" MEGI 2001 ", SH.P.K, ortak i vetem , do te jete: " Ndertimi i objekteve te ndryshme civile e indutriale , private e shtetrore per persona fizike dhe juridike . Importimi dhe eksportimi i mallrave inerte dhe ndertimi si dhe atyre ushqimore e veshmbathje . Transpotimi i udhetareve "**

NENI 5

SHOQERIA mund te ndryshoje emertimin ,vend qendrimin dhe objektin e veprimtarise te saj , vetem me vendim te ortakut te vetem . Ne te gjitha rastet, ndryshimet do te behen me vendim te gjykates,dhe do te pasqyrohen ne zyren e Rregjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane .

## KAPITALI THEMELOR I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themelor i SHOQERISE eshte 100.000 (njeqindmije)leke te reja .Ai , me vendim te ortakut te vetem,munt te shtohet . Kapitali shoqeror mund te jete ne te holla ose kontribut ne natyre . Ky i fundit vleresohet nga nje ekspert i caktuar nga ortaku i vetem .

Kapitali themelor eshte i ndare ne kuota nga 1000 leke , per transferimin e te cilave tek te tretet , eshte koopetent ortaku i vetem .

## ORGANET E SHOQERISE

NENI 7

Ortaku i vetem eshte organi me i larte i SHOQERISE .Vendimet e tij rregjistrohen ne Librin e Shoqerise.

NENI 8

I takon ortakut te vetem e drejta e ndryshimeve te neneve te statutit ,per ritjen ose pakesimin e kapitalit themelur te Shoqerise , per caktimin e perfaqesuesve te saj , per shperndarjen e Shoqerise, drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise, kohe zgjatjen dhe shperndarjen e saj , ndryshimin e selise , krijimin e filjaleve dhe shkrirjen e tyre , marrjen e kredive, miratimin e pages te punesuarve dhe cdo ceshtje tjeter qe e shikon te arsyeshme .

NENI 9

Te gjitha te drejtat qe i takojne asamblese se ortakeve , sipas Ligjit " Per Shoqerite Tregetare ", i takojne ortakut te vetem .

NENI10

Shoqeria administrohet nga nje administrator i vetem , i cili ne kete faze te shoqerise eshte vete ortaku i vetem z.Luan ALLIU . Me kohe , dhe sipas rastit , me vendim te ortakut te vetem mund te caktohet edhe nje person tjeter .

NENI 11

**SHOQERIA TREGETARE " MEGI 2001 "** deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut si dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi , vecanerisht dispozitat urdheruese si dhe ato normative te ligjt 7638 ,date 15.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare" .

**SHOQERIA fiton zotesin per te vepruar, me rregjistrimin e saj ne Gjykaten e Rrethit Tiranre , si person juridik, ndersa ushtron aktivitetin e saj , me rregjistrimin si subjekt privat ne zyren e tatimeve te Rrethit Librazhdit .**
**Emertimi i shoqerise , kapitali themelor dhe emri i administratorit te saj duhet te figurojne ne te gjitha dokumentat e nxjerre prej saj dhe qe i drejtohen te treteve. .**

NENI 12

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen:"SHOQERIA TREGETARE " **MEGI 2001 " SH.P.K**
.Ajo ka llogarine e saj ne leke dhe ne valute ne Bankat e Shqiperise .

NENI 13

SHOQERIA TREGETARE" **MEGI 2001** " vepron ne rregjimin e prones private dhe mer persiper vete te drejta e detyrime kontraktore dhe jo kontraktore brenda kapitalit te saj .

NENI 14

Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise ekonomike ,ortaku i vetem ka te drejte te punesoje punetore per aktivitete te ndryshme , te cilet qendrojne ne detyre deri sa revokohen nga ortaku i vetem , ose largohen me deshiren e tyre .
Administatori vete , ka te gjitha koopetencat per te vepruar me te tjeret , ne interes te Shoqerise . Ne keto raste , shoqeria nuk merr persiper pasojat e te treteve dhe administratori pergjigjet ne menyre individuale

Administratori i emeruar nuk i lejohet qe te veproje jashte koopetencave te tij Ai mund te veproje brenda koopetencave te tij . Ai mund te shkarkohet me vendim te ortakut te vetem .

NENI 15

Kapitali i SHOQERISE ne rast vdekje te ortakut te vetem eshte i trashegushem prej trashegimtareve te tij ligjore.

NENI 16

Mardhenjet e punes ne Shoqerine Tregtare rregullohen nepermjet kontrates se punes . Per ceshtjet qe nuk rregullohen perj saj, zbatohen dispozitat ligjore te legjislacionit shqiptar .
Shoqeria merr persiper qe te rregulloje rregullat ne fuqi te punesimit, e te sigurimeve shoqerore perte gjithe te punesuarit tek ajo, ndersa keta te fundit , te pranojne kete statut te Shoqerise .
Te punesuarit pergjigjen para ligjit dhe statutit per zbatimin e detyrave te ngarkuara si dhe per demet qe ata i shkaktojne Shoqerise . Ata mbajne pergjegjesi penale dhe administrative ne kryerjen e detyrave te tyre .

NENI 17

Mosmareveshjet e te punesuarve me Shoqerine zgjidhen me mirkuptim . Ne te kundert ata mund ti drejtohen Gjykates Shqiptare .

## PERFAQESIMI I SHOQERISE

NENI 18

Perfaqesimi i Shoqerise Tregetare **"MEGI 2001 " , i perket z.Luan ALLIU administator i saj** . Ai ka drejte te perfaqesoje Shoqerine ne organet gjyqesore , ose te caktoje avokat per ceshtje qe kane te bejne me mbrojtjen e interesave te saj.

NENI 19

Shoqeria organizon kontrollin e brendshem me ekspert kontabel te autorizuar , te emeruar , me , ose pa afat te caktuar me mundesi rizgjedhjeje dhe largimi nga puna Ekspertet kontabel kontrollojne dhe garantojne qe llogarite vjetore jane te rregullta , te hartuara me sinqeritet , dhe qe japin pasqyrim besnik te rezultateve te operacioneve te vitit te kaluar financar , te gjendjes financiare e te trashegimise se Shoqerise ne fund te ketij viti financiar .

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 20

Veprimet ekonomike e finaciare te Shoqerise mbyllen me 31.dhjetor te cdo viti . Administratori i shoqerise nxjerr bilancin kontabel me llogarine Humbje -Fitime , inventaret dhe raportet perkatese , ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin , si dhe harton raport me shkrim per administrimin .
Me miratimin e bilancit kontabel vjetor , shoqeria vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per shvillimin e saj si fondin rezerve , ate te akumulimit etj.

NENI 21

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni i plote i saj , me te gjitha ndryshimet e bera deri ne ditet e fundit .Ne seline e shoqerise mbahen te gjitha dokumentat e kontabilitetit per te bere vet kontrollin e shoqerise si dhe per kontrollet nga organet shteterore te autorizuara sipas ligjeve ne fuqi .Dokumentat e mesiperme njihen mire nga administatori i shoqerise.

## SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 22

Shperberja e SHOQERISE TREGETARE mund te vij ne cdo kohe dhe per cfardo shkaku , si ne raste falimentimi , privimi i te drejtave per te ushtruar profesjonin tregtar , forca madhore dhe cdo faktor tjeter qe nuk varet nga deshira e ortakut te vetem . Ne rast likujdimi te shoqerise , emertimi i saj do te pasoje nga shenimin: **" SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER"**.

NENI 23

Ky Statut perpilohet ne disa kopje , per t'iu shperndare organeve perkatese : Gjykates se Rrethit Tirane per te bere veprimet ne rregjistrin tregtar dhe njohjen si person juridik te kesaj shoqerie tregtare .Nje kopje e statutit do ti kaloje sektorit te tatimeve ne Librazhd si subjekt privat dhe marrjen e lejes te ushtrimit te veprimtarise , kurse kopjo e fundit , do te mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te SHOQERISE TREGETARE **"MEGI 2001 " SH.P.K.**.

**ORTAKU I VETEM DHE**
**ADMINISTRATORI I SHOQERISE**
**LUAN ALLIU**

**Tirane me 28.09.2001**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE** **Nr.3245 Rep.**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE** **Nr..202.Kol.**

**V E R T E T I M**

Ne Tirane , sot me daten 28.09.2001 , u paraqit para meje noterit Vangjel DAKA , personalisht z. Luan ALLIU , biri i Eminit , i datelinjes 10.07.1967, banues ne fshatin Hotelisht te Rrethit Librazhdit , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar , identifikuar prej meje nepermjet pasaportes me nr 495728, i cili kerkoi vertetimin noterial te ketij akti redaktuar jashte kesaj zyre , mbi bazen e vullnetit te lire dhe te plote te tij , kurse une noteri e vertetoj sipas ligjes .

**NOTERIA**

**( VANGJEL DAKA )**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**ZYRA E NOTERISE TIRANE**

**Tirane, me 28/9 /2001**

# V E R T E T I M

Me anen e te cilit vertetoj se z Luan ALLIU ka depozituar prane meje noterit Vangjel DAKA shumen prej 100.000 ( njeqindmije ) leke si kapital themelor per krijimin e Shoqerise :'MEGI 2001'SH.P.K.Librazhd.

E leshoj kete vertetim per efekt te rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregetar ne Gjykaten e Rrethit Tirane .

**NOTERI**
**( VANGJEL DAKA )**

26.453/A

By E. Bajo
13.11.2001

13 NOV. 2001

(4)

K E R K E S E

KERKUESI :Luan ALLIU,i njohur si "Person Juridik" te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar,Ortak i Vetem, "MEGI 2001" Hotelisht Librazhd.

OBJEKTI :Depozitim i dokumentave te Shoqerise "MEGI 2001" SHPK Hotelisht Librazhd,per nje "Shtese Objekti" ne veprimtar-ne e saj.

Baza ligjore:Ligji nr.7667,date 28.01.1993:"Per rregjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregetare"neni 33,Kolona 2/c,ç.

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT
T I R A N E

Me vendimin nr.26450,date 28.09.2001 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte miratuar si PERSON JURIDIK "MEGI 2001",Ortak i Vetem,SHPK,Hotelisht Librazhd,me administrator Luan ALLIU,me kapital themelor 100.000 leke te reja,me kohe zgjatje mbi 10 vjet,me seli ne katundin Hotelisht Librazhd,me objekt veprimatarie:"Ndertimi i objekteve te ndryshme civile e industriale,private e shterore per persona fizike dhe juridike.Importimi dhe eksportimi i materjaleve te ndertimit e te atyre inerte,te artikujve industriale dhe ushqimore,si dhe transportim ushetaresh".

Ortaku i vetem i kesaj SHOQERIE,me vendimin e tij nr.1,date 15.10.2001 ka vendosur te beje nje shtese ne objektin e veprimtarise te sa dhe konkretisht:Krijimin e nje Agjensie Treansporti Udhetaresh dhe Mallras ne qytetin e Lobrazhdit.

Mbi sa me siper ,me anen e kesaj kerkese i drejtohemi kesaj Gjykate per te bere ndryshimin e me siperme ne rregjistrin tregetar per ke-te SHOQERI,ne baze te ligjit 7667,date 28.01.1993 "Per regjistrin tregatar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregetare.

KERKUESI
(LUAN ALLIU)

Tirane,me 12.11.2001

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr.2076.Rep.
Nr........Kol.

V E R T E T I M

Ne Tirane,,sot me daten 12.11.2001,para meje noterit Fatmira

**SHOQERIA TREGTARE " MEGI 2001 "**
**SH.P.K. LIBRAZHD**

# V E N D I M
## (I ORTAKUT TE VETEM )

Une ortaku i vetem i SHOQERISE " MEGI 2001 " SH.P.K. me qender ne fshatin Hotelisht te Rrethit Librazhdit, gjate veprimtarise praktike te aktivitetit te kesaj shoqerie konstatova se ne objektin e saj ka mangesi . Ne keto rrethana kerkoj nga Gjykata e Rrethit Tirane , qe objektit te kesaj Shoqerie ti shtohet : Krijimi i nje Agjensie Transporti udhetaresh dhe mallrash , me qender ne Librazhd . Ky ndryshim te pasqyrohet ne zyren e rregjistrit tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane .

**ORTAKU I VETEM**
**LUAN ALLIU**

**Tirane ,me 15.10.2001**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
Nr. 8085

## V E R T E T I M

Sot me daten 13.11.2001 , para meje noteres Fatmara Shehu u paraqit personalisht z. Luan ALLIU , i biri i Eminit , i datelindjes 10.07.1967 , lindur e banues ne katundin Hotelisht te Rrethit Librazhdit , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar , i paisur me pasaporten me nr. 495728 , i cili deklaroje , se sa me siper eshte shkruar sipas vullnetit te tij lire dhe te plote , e neneshkroi ate rregullisht perpara meje noteres , kurse une e vertetoj sipas ligjes .

Taksa pulles
u pagua
100 lek

**NOTERE :**
**FATMARA SHEHU**

# K E R K E S E

**KERKUESI:Luan ALLIU , i biri i Eminit dhe Ballkezes ,** i datelindjes 10.07.1967, lindur ne katundin Hotelisht te Rrethit te Librazhdit dhe banues po atje, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar .
**OBJEKTI: Kerkoj nga Gjykata te marre vendim per rregjistrimin e personit tim si " Person Juridik".**
**Baza juridike:**Ligji nr.7638, date 19.11.1992"Per Shoqerite Tregetare"
Dhe ligji nr.7667 , date 28.01.1993 , " Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhen Respektuar nga Shoqerite ".

26453

## PERPARA GJYKATES SE RRETHIT

## T I R A N E

Une kerkuesi . Luan ALLIU, kerkoj te rregjistrohem ne rregjistrin tregetar te kesaj Gjykate si **" Person Juridik "**, privat , **Sh. P. K.** ortak i vetem , me emrin **" MEGI 2001 ".** Selia e kesaj Shoqerie do te jete ne katundin Hotelisht te Rrethit Librazhdit.

SHOQERIA do te drejtohet nga ortaku i vetem , Z.Luan ALLIU, i cili do te kryeje edhe fuksionet e administratorit . Kapitali themelor i saj do te jete 100.000 leke te reja Afati i saj do te jete mbi dhjete vjet , dhe ka si objekt veprimtarie :" Ndertimi i objekteve te ndryshme civile e industriale , private e shteterore , per persona fizike e juridik. Trasportimi i materjaleve te ndertimit, e atyre inerte , i artikujve idustriale dhe ushqimore .Transport udhetaresh brenda e jashte atdheut.

Duke u nisur nga sa parashtrova me siper , kam besim se kerkesa ime legjitime do te meret ne konsiderate nga ana e juaj , duke me miratuar si "Person Juridik " .

K E R K U E S I :
LUAN ALLIU

Tirane me ,28.09.2001

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 2244 Rep.
Nr. ... . Kol.

## V E R T E T I M

Ne Tirane, sot me daten 28.09.2001 , u paraqit para meje noterit Vangjel DAKA z. Luan ALLIU ,i biri Eminit dhe Ballkezes , i datelindjes 10.07.1967,lindur dhe banues ne katundin Hotelisht te Rrethit Librazhdit, madhor me sotesi te plote juridike per te vepruar , identifikuar prej meje nepermjet pasaportes me nr.495728, i cili kerkoje vertetimin noterjal te kesaj kerkese e redaktuar jashte kesaj zyre, mbi bazen e vullnetit te lire dhe te plote te tij kurse une noteri e vertetoj ate sipas ligjes .

N O T E R I
VANGJEL DAKA